

INFORMATIVE

KRIME
PAVARËSINË
E KOSOVËS!

Orë letrare për Pavarësinë e Kosovës



Sara Rodiqi, fituese në garën për fotografinë më të mirë



Për nder të Ditës së Pavarësisë së Kosovës, nxënësit e klasave të larta mbajtën një orë letrare shoqëruar me pjesë muzikore.

Fituesja e fotografisë më të mirë në mesin e 25 mijë fotografive të publikuara në #instakosova është Sara Rodiqi, nxënëse e shkollës “Mileniumi i Tretë” me fotografinë “N’kamp verës në Ngom Fest, Prizren”. Juria përzgjedhëse ka vlerësuar se fotografia e Sarës është e thjeshtë dhe plot jetë. Gjithashtu, sikur është shprehur juria, kjo fotografi zbukurohet sa herë që e sheh.

Orë letrare për Pavarësinë e Kosovës



Për nder të Ditës së Pavarësisë së Kosovës, nxënësit e klaseve të larta mbajtën një orë letrare të shoqëruar me pjesë muzikore. Ky program artistik u mbajt në Hapësirën për shumë qëllime



Nxënësit që tashmë janë të dëshmuar në artin e shkrimit e sprovuan veten duke lexuar ese me tematika të ndryshme. Niveli përmbajtjesor artistik i eseve i shoqëruar me tingujt e ëmbël të kitarës dhe me zërin magjik të Nidës dhe Erisës i dhanë kuptim këtij organ-

izimi simbolik, që është pjesë e pandashme e nxënësve, e popullit dhe e historisë së Kosovës.

Këtij manifestimi i dha jehonë edhe çmimi që ka marrë nxënësja e shkollës sonë Sara Rodiqi për fotografinë më të mirë në #InstaKosova e nisur nga Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës. Në shenjë respekti dhe vlerësimi për këtë arritje, zëvendësdrojtresha Fitore Hoxha e nderoi me një dhuratë simbolike fituesen e këtij aktiviteti dhe nxënësen tonë, Sara Rodiqi.

PËRMES SYRIT TË SARA RODIQIT

Fituesja e fotografisë më të mirë në mesin e 25 mijë fotografive të publikuara në #instakosova dhe #instakosovo është Sara Rodiqi, nxënëse e shkollës “Mileniumi i Tretë” me fotografinë “N’kamp verës në Ngom Fest, Prizren”. Juria përzgjedhëse ka vlerësuar se fotografia e Sarës është e thjeshtë, plot jetë. Gjithashtu, sikur është shprehur juria, kjo fotografi zbukurohet sa herë që e sheh.



Fituesja e fotografisë më të mirë

Kjo garë është organizuar Sarës përzgjidhet më e publikohen në një libër për herë të dytë si pjesë e m i r a . fotografish cili do të ndahet projektit të Diplomacisë falas në institucione të Digjitale dhe në kuadër të Fituesit e dhjetë fotografive ndryshme shtetërore në festimit të shtatëvjetorit të më të mira janë: Jetmir botë dhe në hapësira të Pavarësisë së Kosovës. Idrizi, Diellza Hasani, ndryshme të artit e kulturës. Juria ka vlerësuar Armend Krasniqi, Agon fotografitë e postuara dhe Sylja, Agron Beqiri, Nita Përveç kësaj, këto fotografi në të gjitha rrjetet sociale Deda, Orgesa Arifi, Fisnik do të jenë pjesë e të cilat reflektojnë mbi Dobreci, Drenusha Lika, ekspozitës #Instakosova e arkitekturën, urbanizmin, N ë n t o r O s e k u . cila do të hapet më 16 natyrën, shoqërinë, jetën shkurt për të festuar e natës, rininë dhe të Fotografia më e mirë shtatëvjetorin e Pavarësisë jetuarit në Kosovë. Në shpërblehet me 500 euro, së Kosovës. Hapja e mesin e rreth 25 mijë kurse 10 fotografitë më të ekspozitë u bë të hënën, fotografive të postuara mira me nga 100 euro. më 16 shkurt 2015, në orën në hashtagët Ndërkohë juria ka 17:00, në Sheshin Nëna #instakosova dhe përzgjedhur edhe rreth 100 Terezë në Prishtinë. #instakosovo, fotografia e fotografi të cilat do të

“Mileniumi i Tretë” nikoqire e shpalosjes së aktiviteteve të projektit vjenez ACES para shkollave publike



Në shkollën tonë u mbajt takimi informues i organizuar nga Akademia e Shkollave të Evropës Qendrore – ACES, me ç’rast shkolla jonë ishte nikoqire, falë angazhimit në këtë projekt për tri herëme radhë dhe interesimit për të qenë pjesëmarrëse në aktivitetet e organizuara nga ky projekt.

Pjesëmarrës në këtë takim ishin përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, Drejtorisë Komunale të Arsimit në Gjakovë, mësimdhënësi të shkollave publike dhe mësimdhënësi të shkollës sonë si edhe dy përfaqësues nga Vceli Dom, organizatë partnere e ACES.

Drejtoresha e shkollës, Afrorre Lila, si nismëtare e këtij projekti, në fjalën përshëndetëse përmendi synimin e shkollës për angazhim në projekte të tilla që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe në arritjen e rezultateve kurrikulare, si dhe inkurajoi të gjithë mësimdhënësit e shkollave publike që të përfshihen në këtë projekt, sepse përveç angazhimit projekti në fjalë do t’u sjellë edhe kënaqësi në raport me shkolla partnere.

Ndërkaq, përfaqësuesi i Ministrisë së Arsimit, z. Ferid Idrizi në fjalimin e tij falënderoi shkollën “Mileniumi i Tretë” për angazhim në këtë projekt dhe përfaqësim të dinjitetshëm të Kosovës në projektin ndërkombëtar dhe rajonal të ACES, ku projektet e shkollës sonë u shpërblyen dy herë radhazi me çmim special të arritshmërisë dhe atë një herë për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe një herë për Pjesëmarrje të Nxënësve. <http://ëëë.aces.or.at/>

Qëllimi i takimit ishte që të njoftohen mësime të ndryshme të shkollave publike të Kosovës rreth mundësisë për pjesëmarrje në këtë projekt, i cili është iniciativë e Erste Foundation me seli në Austri, dhe koordinohet nga Interkulturelles Zentrum nga Austria në bashkëpunim me Vceli Dom nga Sllovakia. Po ashtu, pjesëmarrësit u njoftuan me produktet e zhvilluara nga ACES dhe ekipi menaxhues si Udhëzuesi për Projekte të Shkollave Ndërkombëtare, uebfaqja e re e ACES e cila përfshin edhe metodat e ndryshme që adresojnë tema të ndryshme si Zgjidhja e Konfliktit, Diversiteti, Dialogu Ndërkulturor, Menaxhimi i Projekteve e shumë tema tjera, të cilat mund të realizohen në klasë dhe me nxënës të moshave të ndryshme. Mësime të ndryshme të shkollës, koordinatore e projekteve rajonale, Krenare Lleshi, e cila pati rastin të testojë disa nga këto metoda në shkollën tonë gjatë përgatitjes së tyre dhe fazës së pilotimit, tha se nxënësit mësojnë më së miri kur janë në qendër të mësimit dhe kur përfshihen në procesin mësimor në mënyrë aktive e pikërisht këto metoda iu ofrojnë nxënësve mundësi të punojnë në dyshe apo grupe, të hulumtojnë, të zgjidhin probleme, të diskutojnë, të luajnë role të ndryshme e shumë më shumë.



Gjatë këtij takimi u bë edhe prezantimi i historisë së shkollës sonë në ACES, i cili u përcoll më pas me një video të punuar nga vetë nxënësit dhe ish nxënësit e shkollës "Mil-3", që tashmë janë studentë të universiteteve të ndryshme në Kosovë dhe vende tjera si: Austri, Francë, SHBA, dhe të cilët ishin pjesëmarrës në këtë projekt gjatë tri viteve të fundit. Ndërkaq,

nxënësi Lum Skeja shpallosi para të pranishmëve shumë natyrshëm përshtypjet e tij nga ky projekt.

Pjesëmarrësit, gjithashtu, patën rastin të marrin pjesë në një punëtori të shkurtër gjatë së cilës kohë u bë demonstrimi i dy nga prej metodave të punës në projekt, me ç'rast ata vetë ishin pjesëmarrës në aktivitet.

Më pas u bë edhe prezantimi i temës së projektit për këtë vit, e cila është "Solidariteti" dhe koordinatore e projektit në shkollën tonë, Krenare Lleshi, prezantoi hapat e nevojshëm për t'u bërë pjesë e këtij projekti.

E në fund fare, një nga organizatorët e ACES, e cila ishte pjesëmarrëse në këtë takim, Znj. Danica Lacova, falënderoi edhe një herë shkollën tonë për angazhimin e vazhdueshëm në këtë projekt dhe për mundësinë që i ofroi ACES-it që të organizojë këtë takim në shkollën "Mileniumi i Tretë" me qëllim të promovimit të tij dhe nxitjes së shkollave publike që të marrin pjesë në këtë projekt, meqë Kosova tash e disa vite ka një numër shumë të vogël të aplikimeve.

E premtja relaksuese

Është koha për relaks. Dhe nxënësit zgjedhin ato klube që duan. Kanë mjaft për të zgjedhur, 13 sosh. Një ndonjë klasë debatohet, në ndonjë luhet shah, pingpong, e në ndonjë tjetër këndohet... Pra në shkollë cdo të premtë edhe sivjet funksionojnë klubet, në të cilat nxënësit zhvillojnë pasionet e tyre... Në një nga këto klubet jemi edhe ne, pra Revista M3, që me kënaqësi përcjellim ngjarjet në shkollë, shkruajmë për to dhe i publikojmë këtu në ueb faqe të shkollës sonë. Gjithashtu nxjerrim Letrën informative të shkollës dhe revistën. Me pak fjalë, ne duam të bëhemi gazetarë. Falënderojmë shumë arsimtaren e gjuhës shqipe, Violetë Pllana-Elezi, e cila na motivon cdoherë. Gjithashtu falënderojmë mësimdhënësit tanë që edhe në këto dy orë na qëndrojnë pranë duke na ndihmuar për të ecur para.



Joga, kjo praktikë e lashtë indiane, me anë të së cilës mund të zbulohet brenda vetes forca jetësore, qetësia dhe urtësia sot u praktikua në shkollën tonë. Një grup nxënësish ndoqën veprimet e nxënëses Gresa Isufi, e cila nxiste ata të përqendroheshin jo vetëm tek trupi si fizik, por edhe tek mendja dhe shpirti.



Sporti s'ka se si të mos jetë i parapëlqyeri i shumë nxënësve. Sot u luajt pingpong. Arsimtarët panë mjaft talente në këtë sport.

“Mbretërit” e shahut

Nxënësi i klasës VIII Vijn Baraku është “mbreti” i garës së shahut, pasi doli i pari në finalen e mbajtur të premten, më 23. 1. 2015. Në vendin e dytë u rendit Deni Turku, ndërkaq në të tretin Ardian Kadriu. Të tre këta nxënës shkëlqyen në duelet e tyre mendore në këtë garë. Ata janë shumë të zellshëm në mësimet. Në klasat e tyre veçohen për logjikën e mprehtë, duke analizuar thellë çdo situatë problematike që u shtrohet në orët mësimore.



Shahu është një nga lojërat logjike më komplekse që në shkollën tonë zhvillohet në kuadër të klubit “Shahu”. Çdo të premtë nxënësit

mblidhen për të treguar secili zotësi. Bashkë me mësimdhënësen e fizikës, znj. Merita Berisha ata zbulojnë rrugë të reja për të fituar. Ky klub funksionon që nga shtatori. Siç shprehet znj. Berisha, gjatë dy muajve të parë, shtator dhe tetor, janë organizuar lojëra miqësore, ndërkaq në nëntor, në dhjetor dhe në janar janë mbajtur lojëra garuese, duke mbërritur deri te kjo finale me tre fituesit e përmendur më lart. Shkolla shpërblyeu me dhurata nxënësit fitues, ndërkaq ata u shprehën tejet të motivuar për të vazhduar edhe më tutje garën e mendjemprehtësisë, logjikës dhe përqendrimit.

Pasurojmë fjalorin tonë me fjalë të reja

Nxënësit e klasave të dyta, prej muajit janar filluan aktivitetin “ Pasurojmë fjalorin”. Qëllimi i këtij aktiviteti është që nxënësit të pasurojnë fjalorin e tyre me fjalë të reja. Ata kanë për obligim që një herë në javë të hulumtojnë për një fjalë të re, që nuk është dëgjuar më herët në klasë dhe atë fjalë ta sjellin me sqarim. Gjatë ditës këtyre fjalëve u kushtohet një kohë e caktuar prej 20 minutash që t’i lexojnë dhe t’i analizojnë ato fjalë.



Në hapësirat e të tri klasave, është ndarë një kënd i veçantë në të cilin do të vendosen këto fjalë me qëllimin që nxënësit të kenë mundësinë t’i lexojnë ato brenda dites.



Bashkëpunimi me prindër – Punëdore

Në kuadër të temës mujore “Veshjet”, prindet e klasëve të dyta, ndihmuan nxënësit në realizimin e orës mësimore Punëdore. Prindja e klasës II/1, Teuta Berbati solli materiale të ndryshme me ndihmën e së cilave nxënësit e klasave të dyta punuan veshje të ndryshme, si: veshjet kombëtare, elegante, veshje sipas profesioneve dhe veshje cirku. Nxënësit mësuan për llojet e ndryshme të materialeve si dhe për mënyrën e përdorimit të tyre.



Në klasën II/1 së bashku me fëmijët punuan prindet: Teuta Berbati, Azemine Arifaj dhe Fexhrie Shehu.



Në klasën II/2 ndihmuan prindet: Ariana Deva dhe Minire Gashi.

Ndërsa në klasën II/3 së bashku me fëmijët punoi prindja Valdete Ramadani.

Në këtë orë mësimore fëmijët u treguan organizatorë të punës, bashkëpunues dhe kreativ. Ata ishin shumë falenderues ndaj nënave për kohën që ndanë për ta. Vlen të përmendet që nxënësit përpos që morën njohuri për materialet dhe veshjet e ndryshme, njëherit u argëtuan dhe u ndjenë shumë mirë.



Drita Qosaj bashkë me nxënësit e klasëve të dyta

Mua më dhemb koka, mua fyti, mua barku, mua veshi!!! Po Ty...?! Këto ishin disa nga përgjigjet që nxënësit i shprehën në pyetjen e mjekes: Si ndiheni kur jeni të sëmurë ?

Dr. Drita Qosaj – peditër, njëherit prind i një nxënësi të klasës II/1, u shpjegoi nxënësve arsyet e këtyre ankesave që i treguan ata si dhe kur duhet të kërkojnë ndihmën mjekësore.



Nxënësit treguan përvojat e tyre se si ndihen kur ata janë të sëmurë.

Fëmijët ishin shumë kureshtar të dinin shumë gjëra rreth shëndetit të tyre andaj edhe pyetjet nga ana e tyre nuk kishin të ndalur.

Klasat e dyta falënderojnë Dr. Drita Qosaj për këshillat që iu dha fëmijëve.

Klubi i gatimit



Gjatë ditës së premte nxënësit e klasave 1,2 dhe 3 në Klubin e Gatimit përgatitën ëmbëlsirën: Keksa me puding. Duart e vogla punëtore u kënaqen duke e përgatitur si dhe duke e shijuar ëmbëlsirën.



Sigurt në shkollë, në shtëpi dhe me shokë

Secili fëmijë duhet ta gëzojë të drejtën të rritet dhe të zhvillohet në mjedis të sigurt dhe të qetë. Fëmijët dallojnë nga njëri – tjetri në bazë të gjuhës që flasin, pamjes fizike, gjinisë, racës, aftësive dhe shkathtësive. Me këto fjalë, prindja e klasës II/2, znj. Arta Shala – Visoka, e filloi ligjeratën në klasat e dyta.

Znj. Arta, u dha këshilla nxënësve se si të veprojnë në situata të ndryshme, në mënyrë që ata të jenë të sigurt. Pas shumë diskutimeve dhe pyetjeve të ndryshme, ajo iu shpërndau nxënësve nga një doracak për fëmijët, mbi sigurinë e tyre. Klasat e dyta e falënderojnë znj. Arta për këshillat e dobishme.



Dhurata për gjyshërit



Në kuadër të temës mujore “ Përrallat e gjyshërve”, klasat e dyta punuan në lëndën e Punëdorës për me të dashurit e tyre, Gjyshërit. Ata vizatuan gjyshërit e tyre dhe shkruan fjalët më të ëmbla për ta. Këto punime, nxënësit iu dërguan gjyshërve të tyre, si dhuratë, në shenjë kujdesi për ta.

Nxënësit e shkollës sonë aktivë edhe në sport

Gjatë këtij gjysmëvjetori nxënësit e shkollës "Mileniumi i Tretë" ishin aktivë edhe aktivitetet sportive te organizuara jashtë shkollës.

Ekipi i basketbollit mori pjesë në turneun e organizuar nga Prishtina High School. Ekipi i futbollit ishte pjesëmarrës në turneun e organizuar nga kolegji "Universum" për nder të Festës së Flamurit dhe në turneun e organizuar nga shkolla "Britanica". Këto lojëra u zhvilluan gjatë fundjavave dhe pjesëmarrës ishin edhe shkollat: "Mehmet Akif College", "Don Bosko" si dhe vet shkolla "Britanika". Lojërat e këtij turneu do të vazhdojnë edhe gjatë gjysmëvjetorit të dytë.



Emails to pen friends

5th grade students learned how to write an e-mail to their pen friends during our English classes. After writing their first drafts in class, they went to the computer lab and the students wrote their emails in Edmodo. Afterwards they also played games which help them improve their English.



Hajdutja e librave, një rrëfim tronditës



Kjo është një kohë kur hebrejtë vriten në mënyrë të pamëshirshme dhe si pasojë fëmijët e tyre adoptohen për t'u rritur si gjermanë nga familjet gjermane. Vështirësitë me të cilat përballen këta fëmijë dhe familjarë të vuajtur janë pasqyruar në mënyrë të jashtëzakonshme fillimisht nga shkrimtari i veprës “Hajdutja e librave” Markus Zusak e pastaj edhe nga realizuesit e filmit me po këtë titull.

Ngjarja rrëfëhet nga një narrator jo i rëndomtë, identiteti i të cilit i bëhet i ditur në fillim të rrëfimit. Është pikërisht personifikimi i vdekjes që e shoqëron lexuesin apo shikuesin përgjatë kësaj ngjarjeje. Në shikim të parë, është e lehtë të duket se kemi të bëjmë me një vajzë të rëndomtë gjermane. Mirëpo, e vërteta është se ajo është unike në çdo aspekt tjetër. Lizëlli, ishte bijë e një familjeje komuniste, e cila adoptohet nga dy prindër gjermanë për të jetuar në rrugën “Parajsa”, ku fillon dhe ky rrëfim. Një vajzë e re, me flokë ngjyrë floriri që shkëlqejnë si vetë dielli dhe me

kureshtje të shquar, Lizëlli rëndte pas dijes si një njeri që ecën përgjatë një tuneli të errët në kërkim të dritës.

Dashuria për *fjalët* lind nga kombinimi i kësaj kureshtjeje me xhelozinë ndaj fëmijëve të tjerë të cilët dinin të lexonin. Pavarësisht vështirësive të fillestarit, Lizëlli gjen mbështetjen që i duhej tek babai i saj i adoptuar Hans, i cili si një kujdestar i përgjegjshëm tregon një durim të veçantë teksa përpiqet t'i ndihmojë vogëlushes me mësimet e saj. Në anën tjetër, Rudi, një djalosh i zbehtë i cili e shoqëron Lizëllin në çdo hap të saj, bëhet personi më i dashur për të.

Jeta e Lizëllit fillon një kapitull të ri kur familja e saj vendos të strehojë një hebre të quajtur Maks. I ati i Lizëllit në një formë ishte i detyruar ta ruante këtë djalosh tashmë të rraskapitur nga përndjekja, për shkak të një premtimi të bërë gjatë luftës së shkuar. Si një hije e errët djaloshi çifut u strehua në bodrumin e shtëpisë ku shoqëria e vetme që do të gjente ishte ajo e Lizëllit.

Pasioni i pangopur i Lizëllit nuk resht akoma. E inspiruar nga Maks, ajo reflekton dëshirën e saj për dije. Ajo madje fillon të mbajë një ditar personal në bazë ditore. Lotët që qullojnë faqet e saj nga dëshpërimi që ndjen pas largimit të Maksit, për efekt simbolik pasqyrojnë faqe të reja të ditarit që i shkruan ajo. Përderisa nazistët vazhdojnë marshimin e tyre fatal, i cili rezultoi vdekjeprurës për të gjitha palët e përfshira, Lizëlli vazhdon të dokumentojë përvojën e saj në ditar. Një re vdekjeje përfshin pothuajse të gjithë rrugën “Parajsa” dhe vulos fatet e banorëve të saj. Kjo lagje e paqes dhe e shpresës u shndërrua në një ferr të vërtetë ku u gjet vetëm një i mbijetuar. Ajo ishte Lizëlli.

Vitet kalojnë dhe vdekja, e cila e kishte përcjellë Lizëllin me shumë interesim gjatë gjithë jetës së saj, më në fund e takon atë. Sipas rrëfimit të vdekjes, Lizëlli është njëra nga të paktët njerëz që kishin lënë këtë botë përfundimisht prapa duke qenë plotësisht të bindur se e kishin pëmbushur qëllimin e tyre në jetë.

Shkruan Art Imeri
VIII-2